



Planuar / Dorezuar Punëhet/Prodato Received/Delivery	18-11-2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	5530/2021		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.824/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.824/2021 të datës 21.09.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati dhe Avokat me adresë rruga "Sali Çeku", në Ferizaj, kundër Vendimit me Nr. Prot:245 të datës 13.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore-largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 18.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa më numër A.nr.824/2021 e datës 21.09.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.Prot:08 i datës 12.08.2021 i Komisionit Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës, dhe Vendimi Nr. Prot:245 i datës 13.08.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 07.11.2019 në pozitën Zyrtar i Mbledhjes së Detyrueshme në Administratën Tatimore të Kosovës, me datë 16.09.2021 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Prot:245 të datës 13.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, lidhur me përfundimin e marrëdhënies se tij të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.09.2021 dhe 05.10.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Administrata Tatimore e Kosovës. Këshilli më datë 01.10.2021 dhe 14.10.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.11.2021 ka nxjerr Vendim VK.nr.36/2021 me të cilin ka bërë vazhdimin e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për 10 ditë pune, sipas kërkesës se kryetarit të Kolegjit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.09.2021 e regjistruar me Nr. Prot:4718/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Prot:245 i datës 13.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; Emailin e datës 13.08.2020 nga ankuesi; Raport nga konsulta i datës 23.05.2019, 16.08.2018, 11.08.2020; Raport mjekësor i datës 26.09.2018, Raport Laboratorik i datës 10.01.2020 dhe 01.06.2020; Raport i Kontrolli Biokimik i datës 23.10.2018, 27.09.2018, 10.12.2018; Emailin e datës 01.06.2021 nga ankuesi lidhur me kërkesën për pushim pa pagesë; Raportin nga Konsulta i datës 01.06.2021, 21.05.2021 dhe 31.05.2021; Raportin Specialistik i datës 04.03.2021; Recetë për Barna me Nr.021977; Raport nga Konsulta e datës 09.11.2020; Raport mbi diagnozën i datës 12.10.2020; Autorizim i datës 03.09.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.09.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 04.10.2021; Akt Emërimit e datës 07.11.2019 për ankuesin; Formularin për përshkrimin e detyrave të punës; Emailin e datës 21.07.2021 nga _____ për _____ Shkresë përcjellës për KD e datës 23.07.2021; Njoftim për seancë në Komision Disiplinor e datës 04.08.2021 për ankuesin; Vendimin e datës 07.07.2021 për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor; Vendimin me Nr.Prot:08 i datës 12.08.2021 i Komisionit Disiplinor; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 10.08.2021; Vendimin me Nr. Prot:245 i datës 13.08.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; Emailin e datës 16.08.2021 për ankuesin lidhur me vendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës; Dëshmi për hyrje/dalje në punë për ankuesin nga data 01.06.2021 deri 31.08.2021; Kërkesën për prova shtesë e datës 05.10.2021; Shkresën për dërgimin e dëshmimeve të kërkuar e datës 14.10.2021; Emailin e datës 21.06.2021 nga _____ për _____ Emailin e datës 21.06.2021 nga _____ për _____ Emailin e datës 21.07.2021 nga Selajdin Sylja për Ilir Islami; Emailin e datës 12.08.2021 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 26.02.2021 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 25.02.2021 nga _____ Emailin e datës 25.02.2021 nga _____ për _____ Emailin e datës 12.04.2021 nga _____ për _____ Emailin e datës 08.04.2021 nga _____ Emailin e datës 08.04.2021 nga _____ Emailin e datës 06.04.2021 nga _____ Emailin e datës 08.07.2021 nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 08.07.2021 nga _____ E-mailin e datës 09.06.2021 nga _____ Emailin e datës 09.06.2021 nga _____ për _____ Emailin e datës 08.06.2021 nga _____ Emailin e datës 08.06.2021 nga _____ Qarkoren lidhur me zbatimin e vendimit të Qeverisë 04/14 të datës 28.05.2021 e datës 31.05.2021 e nxjerr nga Drejtori

i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës; Kërkesën për shtyrje të afatit për vendosje e datës 04.11.2021 dhe Vendimi VK.nr.36/2021 i datës 04.11.2021 i Kryesuesit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/07 të datës 18.04.2021 në pikën 4 të tij përcaktohet që Institucionet publike e private dhe subjektet tjera, të paraqiten në punë vetëm me staf esencial, ndërsa me Vendimin Nr. 04/14 të datës 28.05.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është shfuqizuar Vendimi Nr.01/07 i datës 18.04.2021, dhe si rrjedhojë Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës në zbatim të vendimit të Qeverisë, më datë 31.05.2021 ka nxër Qarkore Administrative me të cilin ka obliguar të gjithë të punësuarit në Administratën Tatimore të Kosovës që të paraqiten në vendet e tyre të punës.

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 07.11.2019 në pozitën Zyrtar i Mbledhjes së Detyrueshme në Administratën Tatimore të Kosovës, përmes emailit të datës 01.06.2021, drejtuar Udhëheqëses për Burime Njerëzore, ka kërkuar që t'i mundësohet marrja e pushimit pa pagesë prej një viti. Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore pranë Administratës Tatimore të Kosovës, lidhur me këtë çështje, përmes emailit të datës 21.06.2021 ka kërkuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit rekomandim me shkrim, ndërsa ky i fundit përmes emailit të datës 21.06.2021 ka njoftuar Udhëheqësen e Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës se nuk mund të japë rekomandim pozitiv apo negativ lidhur me pushimin e kërkuar, duke kërkuar nga e njëjta që rasti të trajtohet sipas dokumenteve mjekësore të ofruara nga ankuesi.

Udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankuesit, përmes emailit të datës 08.07.2021 ka njoftuar ankuesin që të paraqitet në punë me datë 09.07.2021 në DMB, Prishtinë. Edhe përkundër kërkesës se udhëheqësit të drejtpërdrejtë, ankuesi nuk është paraqitur në punë dhe një gjë e tillë është dëshmuar nga sistemi i vajtje/ardhjeve në punë, ku ankuesi nga data 01.06.2021 deri më datë 31.08.2021 nuk është paraqitur në vendin e tij të punës, për këtë fakt ndaj ankuesit më datë 21.07.2021 është iniciuar procedurë disiplinore.

Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës, më datë 12.08.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.Prot:08 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "largim nga shërbimi civil", me arsyetimin se ankuesi ka munguar në punë pa arsye me shumë se pesë ditë. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës më datë 13.08.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:245 me të cilin bërë përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesin si rezultat i vendimit të Komisionit Disiplinor. Vendimi i Komisionit Disiplinor dhe Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, ankuesit i është dërguar përmes emailit më datë 12.08.2021, respektivisht më datë 16.08.2021.

Sipas rregullativës ligjore në fuqi për zyrtarët publikë, zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës siç parashihet me nenin 25 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me



këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike”, po ashtu zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas nenit 28 të këtij ligji, zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij, si rrjedhojë ankuesi më mos paraqitjen e tij në punë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: “Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtaret publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik dhe mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore”, andaj meqenëse ankuesi nuk është paraqitur në punë edhe pse i njëjti nuk e ka pasur të aprovuar pushimin pa pagesë, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore, kështu që udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me rastin e parashtrimit të kërkesës për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”.

Po ashtu, Komisioni Disiplinor ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejte ligjin material kur ka konstatuar se i njëjti ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L0114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht shkelje të rënda disiplinore, braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë siç parashihet me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të këtij ligji. Komisioni Disiplinor me rrasatin e nxjerrës së Vendimit me Nr. Prot:08 të datës 12.08.2021, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.* Po ashtu masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenin 48 paragrafi 3, nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 11, nenin 12, nenin 13 paragrafi 3, paragrafi 4 nën paragrafët 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në këtë rast Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës Vendimin me Nr. Prot:08 e datës 12.08.2021 e ka arsyetuar në përputhje të plotë me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit se masa disiplinore e shqiptuar është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi janë të pazbatueshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, si rrjedhojë konstaton se edhe Vendim Nr. Prot:245 i datës 13.08.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit është në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pazbatueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18

paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.824/2021

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës



Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat dhe Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.